

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sika® FerroGard®-903 Plus

IMPREGNIM NGADALËSUES I KORRODIMIT (FORMULË E PËRMIRËSUAR)

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sika® FerroGard®-903 Plus është një inhibitor (frenues) i korrodimit që aplikohet mbi sipërfaqe, i krijuar për përdorim si një impregnim për betonin e armuar. Sika® FerroGard®-903 Plus bazohet në komponentë organik. Sika® FerroGard®-903 Plus depërton betonin dhe formon një shtresë mbrojtëse monomolekulare në sipërfaqen e çelikut të armaturës. Mbrojtja me Sika® FerroGard®-903 Plus vonon nisjen e korrodimit dhe redukton shkallën e korrodimit. Mbrojtja kundër korrodimit me Sika® FerroGard®-903 Plus rrit ciklin e jetës së shërbimit dhe mirëmbajtjes deri në 15 vjet kur përdoret si pjesë e një sistemi të plotë Sika Riparim dhe Mbrojtje Betoni.

PËRDORIMET

- Për mbrojtje kundër korrodimit të strukturave të betonit mbi dhe nën tokë të armuara me çelik
- Si një trajtim për kontrollin e korrodimit për betonin e armuar padëmtuar, ku armatura prej çeliku po korrodohet, ose është në rrezik korrodimi për shkak të ndikimeve të betonit të kontaminuar me karbonim ose klorure.
- Sika® FerroGard®-903 Plus është veçanërisht i përshtatshëm për zgjatjen e shërbimit të betonit me sipërfaqe të dukshme me vlerë estetike, siç janë strukturat historike.

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- I përshtatshëm për metodën 11.3 (aplikim inhibitori tek betoni) përcaktuar nga EN 1504-9 për Parimin 11 (kontroll anodik)
- Nuk ndryshon pamjen e strukturës prej betoni
- Nuk ndryshon vetitë e difuzionit të avujve të ujit tek betoni

- Mbrojtje dhe qëndrueshmëri afatgjatë
- Mund të aplikohet mbi sipërfaqen e riparimeve ekzistuese dhe zonave përreth për të parandaluar fenomenin e "incipient anodes"
- Mbron zonat katodike (parimi 9) dhe anodike (parimi 11) të çelikut të armaturës
- Mund të aplikohet kudo ku opsionet e tjera për riparim/ parandalim nuk është e mundur të aplikohen
- Zgjatje ekonomike e kohës së shërbimit të strukturave prej betoni të armuar
- Aplikim i lehtë dhe ekonomik, i rinovueshëm
- Pajtohet me rregulloren GHS/CLP
- Mund të përdoret si pjesë e një sistemi të thjeshtë, por efikas për riparimin dhe mbrojtjen e betonit
- Thellësia e depërtimit mund të testohet në kantier duke përdorur "Testin e Analizës së Cilësisë (Qualitative Analysis Test)" - për detaje referohuni në departamentin tuaj lokal të shërbimit teknik

MIRATIME / STANDARDE

BRE, Përdorimi i inhibitorit të korrodimit FerroGard 903+ që aplikohet mbi sipërfaqe për vonesën e fillimit të korrodimit të shkaktuar nga kloruret në betonin e ngurtësuar, Raport Klienti BRE Nr. 224-346, 2005
Mott MacDonald, Vlerësimi i inhibitorëve të korrodimit Sika FerroGard 901 dhe 903+, Ref. 26'063/001 Rev A, prill 1996.

SAMARIS (Sustainable and Advanced Materials for Road Infrastructure, Materiale të Qëndrueshme dhe të Avancuara për Infrastrukturën Rrugore) – Raport përfundimtar, Deliverables D17a, D17b, D21 & D25a, Copenhagen, 2006

Mulheron, M., Nwaubani, S.O., Inhibitorë korrodimi për struktura betoni të armuara me performancë të lartë, University of Surrey, 1999

C-Probe Systems Ltd., Performanca e inhibitorit të korrodimit në praktikë, 2000

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

| | |
|-----------------------|---|
| Baza kimike | solucion uhor i amino alkooleve & kripërave të amino alkooleve |
| Ambalazhi | kovë 25 kg fuçi 220 kg |
| Paraqitja / Ngjyra | Lëng transparent, pa ngjyrë në të verdhë të lehtë |
| Jetëgjatësia | 24 muaj nga data e prodhimit nëse ruhet në ambalazhin original, të pahapur dhe të padëmtuar. |
| Kushtet e magazinimit | Të ruhet në mjedis të freskët. Në rast acari (< -5°C), mund të ndodhë kristalizimi i kthyeshëm. Nëse kjo gjë ndodh, lëreni produktin të ngrohet në temperaturë dhome (+15 deri në +25°C), pastaj përzieni mirë për të shpërbërë sërish kristalet. |
| Dendësia | ~1.05 (në +20 °C) |
| Vlera e pH | ~10 |
| Viskoziteti | ~20 mPa·s (Brookfield RVT, aks 2, 100 rpm, 23 °C) |

TË DHËNA TEKNIKE

| | |
|------------------------|--|
| Thellësia e depërtimit | <p>Inspektimi i kantierit dhe testimet eksperimentale tregojnë se Sika® FerroGard®-903 Plus mund të depërtojë në beton në një shkallë prej disa milimetrash në ditë dhe në një thellësi prej afërsisht 25 deri në 40 mm nga 1 deri në 2 muaj. Kjo shkallë depërtimi mund të jetë më e shpejtë ose më e ngadaltë në varësi të porozitetit të betonit. Sika® FerroGard®-903 Plus depërton me mekanizma difuzioni si në fazë të lëngët, por edhe në fazë avulli.</p> <p>Shënim: Nëse pas aplikimit të Sika® FerroGard®-903 Plus, sipërfaqja e betonit është veshur me shtresa mbrojtëse (me bazë çimentoje, akrilik ose impregnim) ose impregnim hidrofobik, shkalla e difuzionit të inhibitorit reduktohet, por nuk ndalon, pasi mekanizmi i difuzionit vepron vetëm në fazën e avullit.</p> <p>Për arsye se cilësia dhe përshkueshmëria e betonit mund të ndryshojë, rekomandohet kryerja e disa testeve paraprake të profilit të thellësisë nga "Analiza e cilësisë" Sika për të vlerësuar shkallën specifike të depërtimit.</p> |
|------------------------|--|

INFORMACIONE MBI SISTEMIN

| | | |
|----------------------|--|--|
| Struktura e sistemit | Sika® FerroGard®-903 Plus është pjesë e sistemeve Sika® për riparimin & mbrojtjen e betonit: | |
| | Sistemi i riparimit | Sika MonoTop®, Sika® Icoment® ose SikaTop® |
| | Kontrolli i korrodimit të armaturës | Sika® FerroGard®-903 Plus |
| | Mbrojtje për betonin | veshjet Sikagard® dhe /ose impregnimet hidrofobe Sikagard® |

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

| | |
|---------------------------|--|
| Konsumimi | <p>Në përgjithësi ~0.50 kg/m² (~480 ml/m²).</p> <p>Për beton shumë të dendur me përshkueshmëri të ulët, shkalla e aplikimit të Sika® FerroGard®-903 Plus mund të reduktohet, por nuk duhet të jetë më e ulët se 0.300 kg/m² (290 ml/m²).</p> <p>Për vlerësimin e kërkesave të projektit, konsumimi dhe thellësia e depërtimit duhet të kontrollohen në kantier duke përdorur "Analizën e cilësisë" Sika - referohuni tek method statement përkatëse.</p> |
| Temperatura e mjedisit | +5 °C min. / +40 °C max. |
| Temperatura e nënshtresës | +5 °C min. / +40 °C max. |

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

Betoni nuk duhet të ketë pluhur, materiale të lira, kontaminime sipërfaqësore, suvatime ekzistuese, kore çimentoje, veshje, vaj dhe materiale të tjera të cilat reduktojnë ose parandalojnë depërtimin.

Nëse nënshtresa do të mbivishet me shtresa të mundshme, profili i sipërfaqes duhet të jetë i mjaftueshëm për të ofruar ndërkapjen e kërkuar.

Betoni i shpetëzuar, i dobët, i dëmtuar dhe i shkatërruar duhet të riparohet duke përdorur llaçet Sika® MonoTop®, SikaTop® ose Sika® Icoment®.

Për beton me sipërfaqe të dukshme ose beton i cili do të mbivishet në vazhdim me shtresa ose impregnim hidrofob, fryni me rrymë uji sipërfaqen e betonit me presion (deri në 18 MPa - 180 bars).

Për sipërfaqe betoni e cila do të mbivishet në vazhdim me material me bazë çimentoje, ashpëroni sipërfaqen duke përdorur teknika të përshtatshme pastrimi me fryrje abrazive ose fryrje me ujë me presion të lartë (deri në 60 MPa - 600 bars).

Për depërtim optimal nënshtresa duhet të lihet të thahet përpara aplikimit të Sika® FerroGard®-903 Plus.

APLIKIMI

Sika® FerroGard®-903 Plus është gati për përdorim dhe nuk duhet holluar. Mos e tundni materialin përpara përdorimit.

Sika® FerroGard®-903 Plus duhet të aplikohet deri në saturim me furçë, rul, pajisje me presion të ulët ose spërkatje pa ajër.

Pas aplikimit të shtresës së fundit, sapo sipërfaqja të bëhet mat, kryeni një pastrim me ujë në presion të ulët (tub uji).

Ditën pas aplikimit, sipërfaqet e trajtuara duhet të pastrohen me pastrim me presion (~ 10 MPa - 100 bars) për të larguar gjurmët e kripërave të tretshme që mund të jenë depozituar mbi sipërfaqe.

Numri i veshjeve:

Varet nga poroziteti dhe lagështia e përmbajtjes e nënshtresës dhe kushtet e motit.

Sipërfaqe vertikale: Normalisht, nevojiten 2 deri në 3 veshje për të arritur konsumimin e kërkuar. Në rast betoni të ngjeshur, mund të kërkohen veshje shtesë.

Sipërfaqe horizontale: Saturoni sipërfaqen me 1-2 veshje, duke u kujdesur që të shmangni grumbullimin e materialit në një vend.

Koha e pritjes midis veshjeve: Kjo varet nga poroziteti i betonit dhe kushtet e motit, normalisht 1-6 orë.

Lejoni që sipërfaqja të thahet midis veshjeve deri në paraqitje mat të lagësht.

MBIVESHJA:

Nëse aplikimi është kryer siç përshkruhet më sipër, nuk kërkohet trajtim i mëtejshëm përpara mbiveshjes me impregnime hidrofobe Sikagard®, veshje transpiruese Sikagard® ose produkte Sikafloor® (për detaje aplikimi, referohuni në skedat teknike përkatëse të secilit produkt).

Nëse do të aplikohen shtresa veshjesh me produkte jo Sika, ju lutemi kontaktoni me departamentin teknik të prodhuesit për të konfirmuar kompatibilitetin me

Sika® FerroGard®-903 Plus ose kryeni prova në kantier për kompatibilitetin dhe ndërkapjen.

Kur Sika® FerroGard®-903 Plus përdoret brenda një pjese të riparuar ose përpara një mbishtrimi me bazë çimentoje, atëherë mund të përdoret sistem Sika për riparim ose mbishtrim. Në vazhdim, duhet të kryhet përgatitja standarde (lagia paraprake).

Kur përdorni shtresë lëmimi/ mbushës poresh mbi sipërfaqen e trajtuar me Sika® FerroGard®-903 Plus, mund të përdoren produkte si SikaTop®-121, Sikagard®-720 EpoCem® ose Sika® MonoTop®-107, SikaTop®-Seal 107, Sika® MonoTop®-723 N, etj. Llaçet me bazë çimentoje për nivelim duhet të përdoren vetëm nëse sipërfaqja është përgatitur mirë dhe ka teksturë të hapur, e cila është pastruar plotësisht nga çdo mbetje.

Nëse do të përdoren produkte të tjera Sika, rekomandohet kryerja e provave në kantier për të konfirmuar përgatitjen dhe përshtatshmërinë.

Nëse do të përdoren produkte jo Sika, ju lutemi kontaktoni me departamentin teknik të prodhuesit për konfirmimin e kompatibilitetin me Sika® FerroGard®-903 Plus ose kryeni prova kompatibiliteti dhe ndërkapjeje në kantier.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni pajisjen e aplikimit me ujë

KUFIZIME

Mos aplikoni kur pritet shi ose ngricë.

Materialet e mëposhtme të ndërtimit duhet të mbrohen nga spërkatjet e Sika® FerroGard®-903 Plus gjatë aplikimit:

- alumini
- bakri
- çeliku i galvanizuar

Nëse produkti aplikohet pranë gurëve natyrorë, mund të nevojitet mbrojtja e tyre nga spërkatjet, pasi mund të ndodhë çngjyrosje.

Defektet e dukshme të betonit (thyerje, plasaritje etj.) duhet të riparohen me metoda konvencionale riparimi (heqja e betonit të shpetëzuar ose të lirë, trajtimet e armaturës, riprofilizimet, etj.)

Ndryshe nga metoda që përshkruhet më sipër, Sika® FerroGard®-903 Plus mund të aplikohet pas punimeve riparuese (por jo të mbiveshjeve mbrojtëse) që janë kryer (pas ngurtësimit të materialit riparues) - zona e saporiparuar mund të mos ketë nevojë të trajtohet me inhibitor. Nëse kjo gjë bëhet, atëherë pritet difuzion më i ulët në zonat që janë riparuar.

Përmbajtja tipike maksimale e klorureve në nivelin e shufrës së armaturës është 1 % për peshë çimentoje pa jone kloruri (që korrespondon me 1.7% klorur natriumi). Mbi këtë limit, sipas udhëzimeve të kantierit dhe nivelit të aktiviteteve korroduese, mund të konsiderohet konsumimi i shtuar i Sika® FerroGard®-903 Plus. Duhet të kryhen testime dhe monitorim i shkallës së korrodimit për të konfirmuar konsumimin dhe efektshmërinë.

Nëse ka klorure prezente pranë shufrave të armaturës, përqëndrimi i Sika® FerroGard®-903 Plus në nivelin e shufrës së armaturës duhet të jetë min. 100 ppm kur matet me kromatografi jonike për të ofruar mbrojtje

efikase. Metoda e detajuar disponohet sipas kërkesës. Mos aplikoni në zona batice ose mbi nënshtresa të saturuara me ujë.

Shmangni aplikimin në rrezatim të drejtpërdrejtë diellor dhe/ose erë të fortë dhe/ose shi.

Mos aplikoni mbi beton që është në kontakt të drejtpërdrejtë me ujin e pijshëm.

Në varësi të kushteve të nënshtresës, aplikimi i Sika® FerroGard®-903 Plus mund të çojë në errësim të lehtë të sipërfaqes. Vazhdoni me testim paraprak.

Të gjitha trajtimet e sipërfaqeve duhet të kryhen me ujë të ftohtë të pijshëm.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porosinë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sika® FerroGard®-903 Plus

Mars 2019, Botimi 02.01

020303040010000016

SikaFerroGard-903Plus-sq-AL-(03-2019)-2-1.pdf

